



**SHPLLJE PËR
LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(Specialist)**

**Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinieri Ndërtimi/Arkitekt” niveli minimal i diplomës
“Bachelor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II ,III,IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore, Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në Shërbimin Civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

- 1 (një) Specialist për Urbanistikën në Sektorin e Shërbimeve Publike në Njësinë Administrative, Njësia Bashkiake Nr.5, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës IV-a;
- 1 (një) Specialist për Infrastrukturën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës, në Njësinë Administrative Baldushk, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës IV-a;
- 1 (një) Specialist për Infrastrukturën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës, në Njësinë Administrative Dajt, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës IV-a;
- 1 (një) Specialist për Urbanistikën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës, në Njësinë Administrative Farkë, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës IV-a;
- 2 (dy) Specialist për Infrastrukturën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës, në Njësinë Administrative Farkë, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës IV-a;
- 1 (një) Specialist për Infrastrukturën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës, në Njësinë Administrative Shëngjergj, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës IV-a;
- 1 (një) Specialist për Urbanistikën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës, në Njësinë Administrative Shëngjergj, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës IV-a;
- 1 (një) Specialist për Administrimin e mbrojtjes së Tokës, në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Njësinë Administrative Farkë, në Bashkinë Tiranë, kategoria e pagës IV-a.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **24.02. 2017**

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: **01.03.2017**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

- Kontrollon zbatimin e ligjeve dhe akteve normative të Këshillit të Ministrave në fushën e shërbimeve publike dhe për parregullsitë e shkeljet që vërehen në veprimtarinë e subjekteve shtetërore apo private në Njësinë Administrative.
- Shqyrton ankesat për ndërtimet pa leje apo mbi zbatimin e lejes së miratuar. Shqyrton ankesat e qytetarëve për dëmtimin e ambientit rrethues. Kontrollon çdo përgjigje të ankesave të qytetarëve nga ana juridike;
- Udhëzon dhe sqaron të gjithë të interesuarit për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për
- aplikim për leje ndërtimi;
- Punon për koordinimin dhe bashkëpunimin me institucionet e ndërmarrjet lokale dhe me organet e tjera të pushtetit vendor për furnizimin me ujë, me energji elektrike, për shërbimin e pastrimit, për grumbullimin e mbeturinave, për mjedisin e gjelbërimin, si dhe për përmirësimin dhe ndërtimin e një infrastrukture rrugore të kohës.
- Grumbullon të dhëna me tregues statistikor, vjetor dhe afatmesëm lidhur me urbanistikën dhe të investimeve publike në Njësinë Administrative. duke bashkërenduar me organizmat e specializuara vendore. Përpunon e përgatit raporte e informacione periodike për drejtimet e mësipërme të detyrave të tij.
- Kontrollon përgatitjen e të dhënave dhe informacioneve për përdorimin e resurseve të tokës sipas kërkesave që bëhen nga Bashkia apo institucione të tjera;
- Shqyrton ankesat që paraqiten nga persona fizikë e juridike që kanë si objekt masat për mbrojtjen e tokës si dhe shmangien e rreziqeve të dëmtimit të tokës bujqësore nga faktorë natyralë e artificialë.
- Ndjek veprimtarinë për evidentimin e tokave bujqësore të pakultivuara si dhe procedurat për qiradhënie të tokave bujqësore në pronësi shtetërore apo në përdorim.
- Bashkëvepron veprimtarinë për mbrojtjen e tokës me njësitë apo bashkitë e tjera që janë kufitare.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë (IV-b/ IV-a);
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Inxhinieri Ndërtimi/ Arkitekt”

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda datës **24.02.2017**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28.02.2017**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015 për Vetëqëverisjen Vendore;
- b- Ligji nr 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- d- Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit“
- e- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“ i ndryshuar
- f- Ligji Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar
- g- Njohuritë mbi ligjin Nr.9244, date 17.6.2004 ”Per mbrojtjen e tokes bujqesore” i ndryshuar.
- h- Ligji Nr.10 257, datë 25.3.2010 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe standat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data **03.03.2017**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Inxhinieri Ndërtimi/ Arkitekt;

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brënda datës **01.03.2017**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.03.2017**, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe standat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **03.03.2017**.